Sekuestrohen dy armë në Suharekë

Suharekë | 05/01/2017 10:22

SHPËRNDAJE

Hetues të Stacionit Policor "Veriu" në Prizren, gjatë intervistës me një person të dyshuar, kanë kuptuar se i njëjti posedon një armë zjarri të llojit kallashnikov.

Ngjarja ka ndodhur pasditen e djeshme në Suharekë ka njoftuar policia.

Lidhur me rastin është informuar prokurori i shtetit me ç' rast janë marrë pëlqimet nga prokuroria dhe gjykata për bastisje. Gjatë bastisjes është gjetur arma- pushkë automatike- me gjashtë fishekë në karikator e cila është sekuestruar dhe e njëjta së bashku me shkresat e lëndes do t'i kalojë prokurorisë për proceduar të më tejme.

Ndërkaq Policia e Suharekës e ka sekuestruar një pistoletë të llojit TT M 57 ngase i dyshuari në cilësi të krushkut - pasi po martonte nipin - ka shkrehur në ajër 8 fishekë nga pistoleta në fshatin Bukosh e që krismat i kishte dëgjuar edhe një patrullë policore e cila ka reaguar. I dyshuari është gjetur në fshatin Doberdelan dhe është pyetur për ngjarjen. I njëjti ia ka dorëzuar një pistoletë policisë. Në të dy rastet, të dyshuarit janë lënë të lirë ndërsa kallëzimet penale do të procedohen sipas procedurës së rregullt.

Kjo web faqe mirëmbahet dhe menaxhohet nga Agjencia e Lajmeve KosovaPress. KosovaPress mban të drejtat e rezervuara me copyright sipas dispozitave ligjore për të drejtat e autorit dhe pronës intelektuale. Përdorimi, modifikimi dhe shpërndarja për qëllime komerciale pa marrëveshje me KosovaPress, ndalohet rreptësisht.

*Të gjitha të drejtat e rezervuara nga A.P.L. KosovaPress - COPYRIGHT
2002-2019*

SHPËRNDAJE

ARTIKUJ TË SPONZORIZUAR

"Al Trade" hap pikën e re në Drenas

Magra Austria, mundësi për pushime fantastike (Foto)

Më shumë nga KosovaPress

Policia italiane sekuestron 400 kilogramë kokainë

Gjykatat Themelore zgjedhin Avni Mehmeti për anëtar të KGjK-së

Goditi për vdekje motoçiklistin, dënohet me katër vjet e dhjetë muaj

Kryeprokurori kërkon themelimin e tri departamenteve në Prokurorinë Speciale

Kriminaliteti ka shënuar rënie në Gjilan

Gjendet një person i vdekur

Lexo të gjitha lajmet

Më të rejat

Kundërshtimi i Qeverisë Kurti është prioritet i opozitës së tanishme

Fëmijët më të rrezikuarit nga bota mediale

Artikuj të sponzorizuar

HerbaLife Nutrition, çelës për një jetë të shëndetshme

Bordi i drejtorëve të RIT Capital, pa vullnetin e tyre, njoftojnë për ndarjen me një nga partnerët e tyre në Ballkan

Art Motion hap pikën e re në qytetin e Mitrovicës

Kjo web faqe mirëmbahet dhe menaxhohet nga Agjencia e Lajmeve KosovaPress. KosovaPress mban të drejtat e rezervuara me copyright sipas dispozitave ligjore për të drejtat e autorit dhe pronës intelektuale. Përdorimi, modifikimi dhe shpërndarja për qëllime komerciale pa marrëveshje me KosovaPress, ndalohet rreptësisht.

Të gjitha të drejtat e rezervuara nga A.P.L. KosovaPress - COPYRIGHT
2002-2019

+383 44 507 766, +383 38 249 721 info@kosovapress.com, marketing@kosovapress.com Hamez Jashari 28 Prishtine